

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6807  
E premte, 20 janar 2023  
çmimi 0.40

Specialja ndryshon datën e konferencës përgatitore ndaj liderëve të UÇK-së | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

INTERVISTË ME PUBLICISTIN MUHAMET MAVRAJ NË EMISIONIN "INFO MAGAZINE" TE "KLAN KOSOVA" MË 18 JANAR 2023 | FAQE 4-5-6

## S'DO TË KISHTE LIRI PA NATO-n, POR AS NATO KURRË PA UÇK-në

### Në Hagë po gjykohet koncepti çlirimtar

Po përpiqen që të konstruktojnë një UÇK që ka luftuar kundër popullit shqiptar



MAVRAJ: PO GJYKOHET KOKA E UÇK-së  
ritanisë së Madhe për Ballkanin Perëndimor, Stuart Peach, gjatë vizitës në Beograd, është shprehur

## KOSOVA PËRBALLET ME VËRSHIME



Reshjet e dendura të shiut në ditët e fundit kanë bërë që disa komuna të përballen me vërshime. Nëpër disa segmente të lumenjve kryesorë janë shkaktuar edhe përmbytje të lokalizuara lumore, duke shkaktuar vështirësi dhe probleme me rrëshqitje të dheut, mbyllje të kanalizimeve dhe vështirësi të qarkullimit, por edhe përmbytje të tokave bujqësore. Komunitat kanë formuar ekipet emergjente institucionale që ta tejkalojnë këtë situatë

### EMISARI GJERMAN: SERBIA NUK MUND TË ANËTARËSOHET NË BE PA E NJOHUR KOSOVËN | FAQE 4



MARRËVESHJA PËR TARGAT, BE-JA THIRRJE KOSOVËS DHE SERBISË TË FOKUSOHEN NË NORMALIZIMIN E RAPORTEVE | FAQE 5

### AKTUALE



RREZIK NGA PËRMBYTJET NË SHOQPËRI, DISA LUMENJ NË PIKËN KRITIKE | F. 2

MEHAJ SHKON NË PEJË DHE ISTOG, PARAQET TË ARRITURAT E MINISTRISË SË MBROJTJES | F. 6

PDK-ja, AKSION NË KUVEND: UNË I BESOJ MARTIN BËRIŞHAJT | F. 7



### EKONOMI



VLERA E KOEFICIENTIT TË PAGAVE MBETET SEKRETE | F. 8

ZKA-ja NIS VITIN ME ZBATIMIN E PLANIT PËR ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË PUNONJËSVE | F. 8

### SPORT



EDHE FIFA KONFIRMON PËRKRAHJEN PËR FUTBOLLIN E KOSOVËS | F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
+389 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Rrezik nga përmbytjet në Shqipëri, disa lumenj në pikën kritike

**TIRANË, 19 JANAR** - Reshjet e shiut në Shqipëri kanë shkaktuar përmbytje, ndërsa rritja e nivelit të ujit në disa lumenj rrezikon ta vështirësojë situatën edhe më shumë. Sipas të dhënave të Ministrisë së Mbrojtjes, në zonën e nënshkodrës afro 1 000 hektarë tokë janë nën ujë, pasi lumi Buna ka dalë nga shtrati në Muriqan dhe në Oblikë, Ndërkaq, në Lezhë ka prani të ujit edhe brenda në qytet. Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, në një konferencë për medie, tha se edhe lumenjtë

Drin, Mat, Shkumbin, Vjosë janë afër pikës kritike dhe rrezikojnë të dalin nga shtrati dhe të shkaktojnë përmbytje në zonat përreth. Peleshi tha se situata është më serioze në veri të vendit, por probleme janë shfaqur edhe në jug, ku ka pasur vërshime të përrrenje malorë e për pasojë edhe rrëshqitje të dheut në rrugë. Situata e krijuar ka detyruar Ministrinë e Arsimit ta pezullojë mësimin në 56 shkolla. Në disa zona në Shkodër, Lezhë, Vlorë,

Korçë ka ndërprerje të energjisë elektrike si pasojë e defekteve që kanë shkaktuar stuhitë e shiut. Policia e Shtetit ka njoftuar se ka rritur praninë në të gjitha akset rrugore, në të cilat janë krijuar vështirësi për shkak të motit të lig. Rreth dy muaj më parë përmbytjet në Shqipëri shkaktuan dy viktima. Si pasojë e përmbytjeve rreth 300 persona janë evakuuar nga banesat e tyre, ndërsa rreth 4.500 hektarë tokë është mbuluar nga uji, kryesisht në qarkun e Shkodrës.



## Jep dorëheqje kryeministrja e Zelandës së Re



**WELLINGTON, 19 JANAR** - Jacinda Ardern ka dhënë dorëheqje nga pozita e kryeministres së Zelandës së Re, duke thënë se nuk i ka mbetur shumë energji për të udhëhequr. Deputetët e Partisë Laburiste do të votojnë të dielën për zëvendësimin e saj. Njoftimi i Ardernit ka ardhur teksa sondazhet kanë treguar se partia e saj përballet me sfidë të vështirë në zgjedhjet e këtij viti që mbahen më 14 tetor. Arden, 42-vjeçare, ka thënë se gjatë pushimeve verore ka pasur kohë që të analizojë të ardhmen e saj, duke shpresuar se do të gjejë energji për të vazhduar.

“Fatqësisht nuk e kam gjetur, dhe unë do t’i bëja shërbim të keq Zelandës së Re nëse do të vazhdoja”, u ka thënë ajo gazetarëve. Ardern do të qëndrojë në pushtet deri më 7 shkurt. Nëse asnjëri prej pasardhësve të saj nuk do të gëzojë mbështetjen e dy të tretave të partisë, votimi do të bartet te anëtarësia e Partisë Laburiste. Më 2017, kur është zgjedhur kryeministre, Ardern ka qenë gruaja më e re në botë në krye të një qeverie, vetëm 37-vjeçare. Ajo e ka udhëhequr Zelandën e Re përgjatë pandemisë së koronavirusit, të shtënave në

xhamitë në Kristçerç, dhe në kohën e një shpërthimi vullkanik. Ajo ka thënë se pesë vjetët e fundit e kanë përmbytur më së shumti, mirëpo udhëheqja e një shteti gjatë “krizave” ka qenë e vështirë. Edhe pse kur është zgjedhur është konsideruar yll politik global, në sondazhet e fundit popullariteti i saj ka qenë në nivelet më të ulëta. Ajo i ka thënë transmetuesit britanik BBC, më 2022, se ulja e popullaritetit ka qenë çmimi që duhet të paguajë Qeveria e saj për mbajtjen e njerëzve të sigurt gjatë pandemisë.

## Gjermania thotë se nuk varet më nga energjia ruse

**BERLIN, 19 JANAR** - Ministri gjerman i Financave, Christian Lindner, ka thënë se Gjermania nuk varet më nga importet ruse për furnizimet me energji. Lindner ka thënë se Gjermania e ka diversifikuar plotësisht infrastrukturën e energjisë prej nisjes së luftës së Rusisë në Ukrainë vitin e kaluar. Pas nisjes së luftës, Rusia e ka ndaluar furnizimin me gaz në Evropë, duke rritur shqetësimet e evropianëve për ndërprerje të

rrymës këtë dimër. Mirëpo Gjermania ka gjetur burime të reja të energjisë, ka thënë Lindner. “Po, natyrisht se Gjermania është ende e varur nga importet e energjisë, por sot, jo nga importet ruse, por nga tregjet globale”, ka thënë ai. Në të kaluarën, Gjermania ka importuar nga Rusia gjysmën e gazit që i është nevojitur, si dhe më shumë se një të tretën e naftës.

Rusia i ka ndaluar furnizimet me gaz në gusht të vitit të kaluar, derisa Gjermania ka hequr dorë nga importet e naftës ruse në fillim të këtij viti. Në garë për të gjetur burime të energjisë, Gjermania ka rihapur termocentralet me thëngjill, nuk i ka mbyllur centralet bërthamore dhe ka shtyrë përpara idetë për magazinim të gazit natyror që importohet nga Norvegjia dhe Shtetet e Bashkuara.



## Në Francë protestohet kundër rritjes së moshës së pensionimit



**PARIS, 19 JANAR** - Sindikatat franceze kanë planifikuar mbajtjen e grevave dhe protestave masive të enjten, për të kundërshtuar planin e presidentit, Emmanuel Macron për të shtyrë moshën e pensionimit. Projektligji, që pritet të diskutohet në parlament, parasheh që mosha zyrtare kur njerëzit mund të ndalen së punuari të rritet nga 62, sa është aktualisht, në 64.

Shërbimet e transportit pritet të çrregullohen keq përgjatë protestës. Shumë shkolla do të mbyllën dhe nuk do të ofrohen shërbimet publike. Në Aeroportin Orly në Paris, një në pesë fluturime është anuluar. Në linjat e metrove në Paris vetëm dy linja që funksionojnë pa shoferë, janë duke punuar normalisht. Protestat pritet të mbahen në Paris dhe qytetet

tjera. Sipas propozimeve të prezantuara më herët gjatë këtij muaji nga kryeministrja franceze, Elisabeth Borne, nga viti 2027, njerëzit do të duhet të punojnë 43 vjet për t’u kualifikuar për pension të plotë, në krahasim me 42 vjet sa është tani. Sondazhet publike kanë treguar se 68 për qind e popullsisë e kundërshton këtë propozim.

# Kosova përballet me vërshime



Reshjet e dendura të shiut në ditët e fundit kanë bërë që disa komuna të përballet me vërshime. Nëpër disa segmente të lumenjve kryesorë janë shkaktuar edhe përmbytje të lokalizuara lumore, duke shkaktuar vështirësi dhe probleme me rrëshqitje të dheut, mbyllje të kanalizimeve dhe vështirësi të qarkullimit, por edhe përmbytje të tokave bujqësore. Komunitat kanë formuar ekipet emergjente institucionale që ta tejkalojnë këtë situatë

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 19 JANAR - Reshjet e dendura të shiut në ditët e fundit kanë bërë që disa komuna të përballet me vërshime. Si pasojë e reshjeve të shiut në ditët e fundit disa lumenj, kryesisht ata me karakter të rrëqeve, kanë paraqitur disa vërshime të shpejta, ndërsa nëpër disa segmente të lumenjve kryesorë janë shkaktuar edhe përmbytje të lokalizuara lumore, duke shkaktuar vështirësi dhe probleme me rrëshqitje të dheut, mbyllje të kanalizimeve dhe vështirësi të qarkullimit, por edhe përmbytje të tokave bujqësore.

Si rrjedhojë e reshjeve të pandërprera, situata është renduar në komunën e Skenderajt. Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme në gjithë territorin e komunës. "Kam formuar Shtabin Emergjent, i cili tashmë ndodhet në

teren dhe po e bën punën e vet. Që në orët e mëngjesit secila drejtori me njësitë dhe shërbimet vartëse, ndërkohë që edhe me mbështetje të Shërbimit të Zjarrfikësve, është angazhuar ta bëjë maksimumin e punës që situata të jetë nën kontroll, me gjithë vështirësitë dhe kapacitetet ekzistuese karshi sasisë së madhe të ujit nga reshjet e shiut", ka thënë Nura.

Po ashtu, reshjet e dendura të shiut në ditët e fundit kanë bërë që disa zona në komunën e Podujevës të përballet me vërshime. "Si institucione lokale që nga mëngjesi jemi në terren duke intervenuar në zonat më të prekura. Momentalisht kemi katër ekipe të cilat janë duke intervenuar në këto zona. Zonat më të prekura janë Pakashtica, Kërpimehi, Letanci, Perani dhe Obrança, po ashtu edhe disa rrugë janë përshkuar nga uji duke vështirësuar qarkullimin në komunikacion. Situata është e menaxhueshme, por me tendencë



të përkeqësimit për shkak të reshjeve të pandërprera të shiut", ka thënë kryetari i kësaj komune, Shpejtim Bulliqi.

Ai ka apeluar te të gjithë qytetarët të bashkëpunojnë me ekipet emergjente institucionale në mënyrë të tejkalohet sa më shpejt kjo situatë.

Gjithashtu, vërshime ka pasur të enjten edhe në komunën e Mitrovicës. Kryetari Bedri Hamza së bashku me nënkryetarin e komunës, Arian Tahiri, si dhe drejtorët komunalë, kanë përcjellë nga afër situatën e krijuar nga reshjet e shiut. Me këtë rast, kryetari Hamza ka bërë me dije se për momentin gjendja

është e menaxhueshme deri në një masë, ndërkohë që komuna ka mobilizuar të gjithë operatorët dhe ka ngritur kapacitetet e saj për tejkalimin e kësaj situatë. "Brenda kapaciteteve tona jemi duke i marrë të gjitha masat e nevojshme, ku kemi mobilizuar të gjithë operatorët e nevojshëm dhe së bashku me ta jemi në terren. Reshjet e dendura kanë bërë që niveli i ujit në lumenjtë e qytetit të Mitrovicës të rritet dhe kjo ka shkaktuar një situatë serioze, prandaj jemi duke e vëzhguar situatën nga afër", është shprehur Hamza.

Më tutje, kryetari Hamza ka apeluar te qytetarët për kujdes të shtuar për shkak të të reshurave të shiut që kanë përfshirë komunën tonë, ku niveli i ujit përgjatë lumenjve është rritur, "mirëpo ne do të jemi në terren bashkë me ekipet emergjente deri në uljen e të reshurave dhe për të ndërhyrë në zonat më kritike".

Të reshurat e dendura të shiut kanë vështirësuar qarkullimin edhe në komunën e Drenasit, ku në disa zona është përkeqësuar gjendja

Komuna e Drenasit ka njoftuar të gjithë qytetarët se pas të reshurave të vazhdueshme të shiut, disa rrugë, sidomos mbi ura dhe te rrethi në dalje të qytetit, janë bërë vështirë të kalueshme, ndaj ka kërkuar nga qytetarët të kenë kujdes dhe t'i evitojnë zonat ku ka rrezik të qarkullimit.

Ekipet emergjente janë në terren dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë përmes kompanisë së kontraktuar është duke bërë zhblokimin e kanalizimeve aty ku është bllokuar.

Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, u ka bërë thirrje qytetarëve që t'i shmangin daljet pa nevojë dhe t'u shmangen reziqeve në rrugët ku vërshimet janë më të dendura. Lladrovci ka kërkuar që qytetarët të kenë mirëkuptim e bashkëpunim për ta tejkaluar gjendjen e krijuar nga të reshurat e dendura të shiut.

Gjendje jo e mirë nga vërshimet është edhe në Klinë, Istog, Pejë dhe Deçan.



## Trusti nuk kalon, Vetëvendosje sërish voton kundër

Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk e ka përkrahur Projektligjin nr.08/L-178 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet

Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-115, me Ligjin nr. 04/L-168 dhe Ligjin nr. 05/L-116.

Kundër këtij projektligji kanë votuar shumica e deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje. Në favor të këtij projektligji kanë votuar 42 deputetë dhe 55 kundër.

Një iniciativë e tillë kishte dështuar edhe vitin e kaluar, pasi nuk ishte përkrahur po ashtu nga deputetët e Vetëvendosjes.





## Marrëveshja për targat, BE-ja thirrje Kosovës dhe Serbisë të fokusohen në normalizimin e raporteve

**PRISHTINË, 19 JANAR** - Bashkimi Evropian ka bërë thirrje që Kosova dhe Serbia të përmbahen nga secili veprim që mund ta destabilizojë situatën, edhe ashtu të brishtë, dhe që çfarëdo sqarimi rreth interpretimeve për marrëveshjen për targat ta adresojnë në kuadër të dialogut.

Duke u përgjigjur në pyetjet rreth akuzave që kanë shkëmbyer Kosova dhe Serbia për mosrespektimin e marrëveshjes rreth targave, zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka thënë se të gjitha palët duhet të përmbahen nga veprimet e njëanshme. "BE-ja kërkon nga të gjitha palët t'i respektojnë në tërësi dhe pa kushte marrëveshjet dhe aranzhimet e arritura më 23 nëntor të vitit të kaluar, me të cilat edhe Kosova edhe Serbia u pajtuan për masat specifike rreth targave për t'i ulur tensionet dhe për t'u fokusuar në tërësi te propozimi i BE-së për t'i normalizuar raportet e tyre" ka

thënë Stano.

Me marrëveshjen e nëntorit, Kosova u ka dhënë fund veprimeve të mëtejme të lidhura me reregjistrimin e makinave me targa serbe që qarkullojnë në Kosovë, derisa Serbia është pajtuar që të mos lëshojë më targa të makinave me emra të qyteteve të Kosovës.

Më 18 janar ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, ka thënë se Kosova nuk do ta lejojë hyrjen dhe qarkullimin e veturave që kanë targat ilegale serbe KM e që janë reregjistruar nga dhjetori i vitit të kaluar dhe tutje. Siç ka mësuar REL-i, bëhet fjalë për makina që janë regjistruar pas datës 7 dhjetor 2022, kur ka hyrë në fuqi dekreti i ri i qeverisë serbe për veturat që kanë targa me akronime serbe për qytetet e Kosovës dhe të cilat janë të regjistruara në Serbi.

Duke komentuar vendimin e autoriteteve të Kosovës, drejtori i Zyrës për Kosovën në qeverinë serbe, Petar Petković, e ka akuzuar

Kosovën se po tenton të shkaktojë krizë dhe tensione të reja.

Stano e ka komentuar të enjten marrëveshjen e arritur në nëntor. "Kjo do të thotë që Kosova të përmbahet nga çfarëdo veprimi ndaj atyre pronarëve që kanë targat KM dhe efektivisht të mbajë status-quo derisa të mos arrihet një zgjidhje më e qëndrueshme në dialog. Kjo, po ashtu, do të thotë që Serbia të mos lëshojë targa të reja KM. Ne gjithashtu kemi marrë parasysh vendimin e Serbisë, më 6 dhjetor 2022, që letrat ngjitëse të regjistrimit për targat KM nuk do të rinovohen. Ne kuptojmë se rinovimi i sigurimit dhe kontrolli teknik ka të bëjë me automjetin e jo me tabelat e regjistrimit, dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet rinovimi i tabelave të regjistrimit", ka thënë Stano, duke i ftuar palët ta respektojnë marrëveshjen. "Por gjithsesi, ne i ftojme të gjitha palët që të respektojnë marrëveshjen dhe të fokusohen në normalizimin

e raporteve, sipas propozimit të BE-së, dhe çfarëdo pyetje rreth interpretimeve të asaj se çfarë është rënë dakord më 23 nëntor, të diskutohet përmes dialogut, e jo përmes veprimeve të pakoordinuara në terren, që mund ta destabilizojnë situatën edhe ashtu fragile", ka thënë zëdhënësi i BE-së.

Stano ka përmendur se suksesi në dialogun mes dy palëve është thelbësor për rrugën e dy vendeve drejt integriteteve evropiane. "Të dyja palët duhet t'i trajtojnë këto diskutime si prioritet". BE-ja, ndërkohë, ka konfirmuar se më 20 janar përfaqësuesi i posaçëm evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčak, do të udhëheqë një vizitë të diplomatëve evropianë dhe amerikanë në Prishtinë dhe Beograd.

Delegacioni do të përfshijë të dërguarin amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, këshilltarë të kancelarit gjerman

dhe presidentit francez, si dhe një këshilltar të kryeministres italiane. Qëllimi i vizitës, sipas burimeve evropiane, është përgatitja për mbajtjen e një takimi të ri mes kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në Bruksel.

Tash për tash nuk ka asnjë konfirmim se kur do të mund të zhvillohet një takim i tillë.

Kurti dhe Vuçiqi janë takuar për herë të fundit në Bruksel më 21 nëntor.

Kosova dhe Serbia kanë nisur negociatat për normalizimin e marrëdhënieve më 2011 me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian.

Procesi i negociatave pritet të përfundojë me marrëveshje ligjrisht të detyrueshme.

Ndonëse Kosova deklaroi se kjo marrëveshje duhet ta përfshijë njohjen e ndërsjellë, Serbia nuk pranoi, duke insistuar në "zgjidhje kompromisi".

## Specialja ndryshon datën e konferencës përgatitore ndaj liderëve të UÇK-së

**Hagë, 19 janar** - Gjykata Speciale ka ndryshuar datën e mbajtjes së konferencës përgatitore të prokurorit të specializuar për seancën e gjykimit ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Ajo ka vendosur që më 15 shkurt të mbahet seanca e radhës përgatitore.

Më herët prokurori i specializuar, Matthew Howling, kishte caktuar 17 shkurtin datë të seancës së radhës

përgatitore, në të njëjtën ditë me përvjetorin e 15-të të Pavarësisë së Kosovës dhe kjo ka shkakuar reagime të shumta në opinion.

Konferenca e fundit përgatitore për seancën e gjykimit ndaj ish-kryerëve të UÇK-së është mbajtur më 18 janar dhe është vendosur që gjykimi të fillojë në muajin mars.

Aktakuza ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është konfirmuar më 26 tetor 2020.



# Emisari gjerman: Serbia nuk mund të anëtarësohet në BE pa e njohur Kosovën



I dërguari i posaçëm i Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, ka thënë të enjten se qëndrimi i Berlinit është se Serbia nuk mund të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian pa e njohur Kosovën. “Ne nga Gjermania kemi pasur gjithmonë qëndrim shumë të qartë për këtë çështje para përfundimit të procesit të normalizimit të marrëdhënieve, kur Serbia të vendosë për anëtarësim në BE, njohja e Kosovës do të jetë pjesë e procesit”, ka thënë Sarrazin. BE-ja ka konfirmuar se më 20 janar përfaqësuesi i posaçëm evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, do të udhëheqë një vizitë të diplomatëve evropianë dhe amerikanë në Prishtinë dhe Beograd.

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 19 JANAR - I dërguari i posaçëm i Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, ka thënë të enjten se qëndrimi i Berlinit është se Serbia nuk mund të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian pa e njohur Kosovën. Duke folur për gazetën serbe “Nova”, Sarrazin tha se hyrja e Serbisë në familjen e vendeve evropiane “nuk është e mundur as pa mediet e lira dhe demokraci”. “Ne nga Gjermania kemi pasur gjithmonë qëndrim shumë të qartë për këtë çështje para përfundimit të procesit të normalizimit të marrëdhënieve, kur Serbia të vendosë për anëtarësim në BE, njohja e Kosovës do të jetë pjesë e procesit”, ka thënë Sarrazin.

Ai shtoi se një gjë e tillë “është diçka që Gjermania gjithsesi e pret”, dhe se “kjo është shprehur qartë nga kancelari Olaf Scholz gjatë vizitës së tij në Serbi në qershor të vitit të kaluar”. Sarrazin tha se BE-ja është udhëheqësja e negociatave ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe se është e domosdoshme që palët të arrijnë marrëveshje sa më shpejt që është e mundur. Sarrazin është i dërguari i parë gjerman për Ballkanin Perëndimor, pasi kjo pozitë nuk ka ekzistuar në qeveritë e mëparshme gjermane. BE-ja, ndërkohë, ka konfirmuar se më 20 janar përfaqësuesi i posaçëm evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, do të udhëheqë një vizitë të diplomatëve evropianë dhe amerikanë në Prishtinë dhe

Beograd. Delegacioni do ta përfshijë të dërguarin amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, këshilltarë të kancelarit gjerman dhe presidentit francez, si dhe një këshilltar të kryeministres italiane. Qëllimi i vizitës, sipas burimeve evropiane, është përgatitja për mbajtjen e një takimi të ri në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në Bruksel. Tash për tash nuk ka asnjë konfirmim se kur do të mund të zhvillohej një takim i tillë. Kurti dhe Vuçiqi janë takuar për herë të fundit në Bruksel më 21 nëntor. Kosova dhe Serbia kanë nisur negociatat për normalizimin e marrëdhënieve më 2011 me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Procesi i negociatave pritet të përfundojë me marrëveshje ligjërish të detyrueshme. Ndonëse Kosova deklaroi se kjo marrëveshje duhet ta përfshijë njohjen e ndërsjellë, Serbia nuk pranoi, duke insistuar në “zgjidhje kompromisi”. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, para vizitës së tij në Forumin Ekonomik Botëror në Davos, ka paralajmëruar rrezikun e “hegemonisë pansllave” të Serbisë dhe Rusisë në Ballkan. Në një intervistë për gazetën

zvicerane “Tages-Anzeiger”, Kurti ka theksuar se Serbia nuk është një vend normal, sepse nuk është distancuar nga trashëgimia e kohës së diktatorit Slllobodan Millosheviq. “Tani shtojni kësaj mosdistancimin ndaj Vladimir Putinit dhe luftës së tij në Ukrainë. Demokracia ishte një interludë e shkurtër në Serbi pas përfundimit të diktaturës. Së shpejti do të bëhen 20 vjet qëkur kryeministri prorepublican serb Zoran Djindjic u vra në Beograd. Që atëherë, forcat e errëta në Serbi festojnë rikthimin. Beogradi kërkon një marrëdhënie me fqinjët e tij të ngjashëm me atë që ka Moskë me Ukrainën dhe Bjellorusinë. Prandaj kjo fqinjësi është një rrezik sigurie për ne”, ka deklaruar Kurti. Ai ka thënë se Kosova është e interesuar për të arritur një normalizim të plotë të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve bazuar në njohjen reciproke. “Ne jemi gjithmonë të gatshëm për një dialog konstruktiv”, ka deklaruar Kurti. I pyetur se çfarë kupton me hegemoninë pansllaviste?, Kurti është përgjigjur: “Serbia dëshiron Republikën Serbe në Bosnjë, Malin e Zi dhe veriun e Kosovës dëshiron ta kthejë në një sferë të ndikimit. Njëjtë siç sillet Rusia me Bjellorusinë dhe Ukrainën. Problemi ynë është se partnerët tanë republikanë

besojnë se Serbia po udhëhiqet vetëm nga oportunitizmi, se është në pritje të përfundimit të epokës së Putinit dhe pastaj do të orientohet qartë drejt Evropës. Kjo është naive. Aleksandër Vuçiq më shumë pret kthimin e Donald Trump në Uashington sesa fundin e luftës në Ukrainë. 80 për qind e popullsisë ka një opinion pozitiv për Vladimir Putin. Serbia e sheh veten si pjesë e një sfere pan-sllave, ortodokse jashtë Evropës”, ka thënë Kurti. Gjatë vizitës në Kosovë, zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Jashtme e Sllovenisë, Tanja Fajon, ka thënë se Kosova dhe Serbia duhet të diskutojnë për propozimin e BE-së për normalizim të raporteve. Ajo ka theksuar se nuk bën të ketë eskalim të situatës në veri të Kosovës. “Gjithmonë kam thënë që Kosova duhet të përpiqet për normalizim e marrëdhënieve, nuk bën të bëhet eskalimi i situatës andej. Duhet të fillojnë negociatat për propozimin e BE-së që është në tavolinë për normalizimin e marrëdhënieve”, ka thënë Fajon. Ajo ka shtuar se Sllovenia mbështet dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. “Ne duam që jeta të bëhet sa më e thjeshtë për të gjithë qytetarët. Të gjithë jemi të shqetësuar për rreziqet e sigurisë në Ballkan. Kemi nevojë për një Ballkan dhe Kosovë të fortë”, ka thënë Fajon.

INTERVISTË ME PUBLICISTIN MUHAMET MAVRAJ NË EMISIONIN “INFO MAGAZINE”  
TE “KLAN KOSOVA” MË 18 JANAR 2023

# S’do të kishte liri pa NATO-n, por as NATO kurrë pa UÇK-në

## Në Hagë po gjykohet koncepti çlirimtar



## Po përpiqen që të konstruktojnë një UÇK që ka luftuar kundër popullit shqiptar

**Intervistuan:**  
Arbëresha SHPATI dhe  
Vullnet KRASNIQI

**“Info Magazine”:** Pikërisht për Gjykatën Speciale siç ju paralajmëruam do të bisedojmë me publicistin, gazetarin dhe veprimtarin Muhamet Mavraj. Z. Mavraj, faleminderit shumë për kohën!

**Mavraj:** Respekt!

**“Info Magazine”:** Z. Mavraj a mund të themi se sërish po vjen një mars i rëndë për ish-ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) marrë parasysh se kjo mund të jetë edhe periudha e fillimit të procesit gjyqësor ndaj ish eprorëve të saj?

**Mavraj:** Po! Është mars i

vështirë dhe do të përzihen simbolikat. Në fakt, kundërshtohen simbolikat e marsit të cilat për neve dihet deri më tani se çfarë kanë qenë, çfarë kanë përmbajtur dhe se çfarë motivi i kanë sjell kombit shqiptar nëpër dekada e nëpër shekuj, veçanërisht këta marsat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Por, hiç më i lehtë s’do të jetë as 17 shkurti 2023 (i seancës së radhës në Hagë), para se të fillojë procesi gjyqësor në mars, sepse 17 shkurti është dita kombëtare e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Mund ta keni vërejtur deri më tani, rregullisht datat e seancave caktohen nëpër data që përmbajnë histori për Kosovën. Paralelisht me to Gjykata Speciale përpiqet që të përçojë

mesazhe të kundërta me ato të historisë së Kosovës. Është njëfarë ironie dhe njëfarë cinizmi i rregullt i kësaj gjykate.

### Gjykata Speciale vetëm emrin e ka të Kosovës

**“Info Magazine”:** Z. Mavraj, a e konsideroni së është e qëllimshme që bëhet kjo, meqë Gjykata Speciale është e Kosovës, por që ndodhet në Hagë, meqë është votuar prej Kuvendit të Kosovës, por nuk respektohen datat e festave zyrtare të cilat i kemi me ligj në Kosovë?

**Mavraj:** Kjo gjykatë s’ka asgjë të Kosovës, përjashtimisht emrit. As nuk e ka personelin, as përmbajtjen, as qëllimin fare hiç për Kosovën ose për drejtësinë. Nëse e vizitoni vetë

Gjykatën Speciale ose burgjet ku janë të paraburgosurit tanë nuk do ta keni fare ndjesinë se jeni në një paraburgim të ndonjë institucioni të Kosovës, e gjithashtu personeli (gjyqësor) i mëparshëm i UNMIK-ut, i cili ka pasur një nam shumë negativ këtu në Kosovë, veçanërisht këta të EULEX-it të cilët kanë qenë të përzier në aferat të rënda, negative, të ngritura nga vetë kolegët e tyre këtu në EULEX, gjatë shërbimit në Kosovë, të japin të kuptosh krejtësisht diçka tjetër për Gjykatën Speciale. Edhe pse e bartin emrin e Kosovës ata rregullisht punojnë që të japin mesazhe se UÇK-ja është diçka tjetër, datat që i ka krijuar UÇK-ja në Kosovë janë diçka tjetër, ndërsa vetë UÇK-ja është diçka tjetër. Dhe s’është e rastësishme porosia kryesore që e tha gjyqtarja gjatë shqiptimit të aktgjykimit kundër Salih Mustafës, aktgjykimit dënues, ku potencoi se që të gjitha viktimat janë shqiptarë. Pra, ata po

përpiqen që të konstruktojnë një UÇK që ka luftuar kundër popullit shqiptar. Prandaj, si një lloj cinizmi, si një lloj, si të thuash, kundërshtimi ndaj frymës, zëmrës së kombit shqiptar, nuk është çudi që e caktojnë 17 shkurtin për seancë gjyqësore të radhës, nuk është çudi që gjatë marsit caktojnë edhe data karakteristike që këtu në Kosovë përkuqtohen për diçka tjetër, e kështu më radhë. Fatkeqësisht! E them me keqardhje, por kjo është e vërteta.

### Kurrë nuk do të kishte çlirim të NATO-s pa UÇK-në

**“Info Magazine”:** Z. Mavraj, në vendimin që e përmendët, të cilit ju iu referuat si rasti i Sali Mustafës, aty përmendet nga ana e gjykatës se kjo gjykatë nuk po e gjykon Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, por individët që sipas tyre mund të kenë kryer krime apo në rastin e Salih Mustafës,

gjykata po vlerëson se është kryer krim... Cili është vlerësimi juaj me këtë mënyrë të formulimit edhe të dënimit ku në emër të popullit dënohen ish eprorët e UÇK-së dhe në anën tjetër përmendet se kjo gjykatë nuk po e gjykon UÇK-në, por individë brenda saj?

**Mavraj:** Është ironike, sepse atje në fund të fundit nuk gjykohen çfarëdo eprorësh. Atje, faktikisht është koka e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), janë strategët e lirisë, janë anëtarët kryesorë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, pa të cilët ose pa vizionin e tyre Kosova do të vonohej shumë dhe ne nuk do të ishim këtu sot. Në opinionin e përgjithshëm hasim përplot fraza që thonë se Kosovën e ka çliruar NATO, gjë që është shumë e vërtetë. Por, ashtu siç mund të thuhet se s'mund të kishte liri të Kosovës pa NATO-n, kurrë nuk do të kishte NATO pa UÇK-në! Prandaj, janë aq shumë të ndërlidhura këto fenomene, këto koncepte, sa që duhet të jemi shumë të matur dhe shumë të kujdesshëm kur publikisht i gjykojmë (këta strategë) sepse faktikisht e gjykojmë vetveten. Nuk është e vërtetë se atje po dënohen individët e UÇK-së, por atje po gjykohet thjesht koncepti çlirimtar.

**Duhet të formohet një organ vëzhgues për Gjykatën Speciale, një komision faktmbledhës, ta shmangim termin "kontroll"**

**"Info Magazine":** Z.Mavraj, përmes aspekteve procedurale, pra gjyqësore të cilat në vazhdimësi kritikohen, qoftë edhe sa i përket kohëzgjatjes, vënë në dyshim edhe kredibilitetin e gjykatës. Pra, ka raportime në media, dokumente... dhe aq më tepër që nuk ka një organ mbikëqyrës sa i përket punës së kësaj gjykate. Në vlerësimin tuaj, z. Mavraj, cili mendoni se do të jetë epilogu ose si do të jetë rrjedha e gjithë këtij gjykimi marrë parasysh të gjitha këto elemente që ndërlidhen jo vetëm me procedura, por edhe çështje të tjera?

**Mavraj:** Kolegu im, Vullnet, dënimi për këta njerëz, udhëheqës të luftës çlirimtare të Kosovës është ky: mbajtja në paraburgim, ashtu siç ka qenë dënim në rastet Limaj dhe Haradinaj. Ata i dëmtuan duke i mbajtur në paraburgim, ishin paraburgime të gjata. Po kështu ka qenë edhe në rastet e komandantëve të zonave në Kosovë dhe siç e dini s'ka dalë gjë, fare hiç, nga ato aktgjykime



**Mavraj:** Në opinionin e përgjithshëm hasim përplot fraza që thonë se Kosovën e ka çliruar NATO, gjë që është shumë e vërtetë. Por, ashtu siç mund të thuhet se s'mund të kishte liri të Kosovës pa NATO-n, mund të thuhet lirisht se kurrë nuk do të kishte NATO pa UÇK-në

që i kanë udhëhequr po këta njerëz, përafërsisht, që të gjithë të huaj, Unmik e Eulex. Tani tek çështja e mekanizimit mbikëqyrës: shteti i Kosovës është burimi i saj gjykate dhe shteti i Kosovës si shtet sovran i ka të gjitha të drejtat që të ndërmarë veprime të arsyeshme ligjore dhe politike lidhur me këtë gjykatë. Atë e ka krijuar Kuvendi i Kosovës, nuk është e lehtë proceduralisht që

të zhbëhet, por as e pamundshme jo. Mirëpo, ka mundësi të tjera, pa e zhbërë fare këtë gjykatë, fillimisht, Kuvendi të formojë një komision faktmbledhës që mbledhë fakte për të gjithë veprimtarinë e Gjykatës Speciale, edhe përpara se ta arrestoheshin këta, që nga dita e fuqizimit të ligjit për themelimin e Gjykatës Speciale, viti 2015. Të mbledhë fakte për

çdo segment të mundshëm të funksionimit të kësaj gjykate, pavarësisht se ky shtet vetë nuk e financon, dhe ta shmang fillimisht me çdo kusht termin "kontroll", të kemi kujdes, sepse kjo gjykatë është formuar për t'ia hequr barrën Kosovës, t'ia heq presionin Kosovës dhe që Kosovën ta nxjerrë ashtu siç është në fakt, të pastër, pavarësisht sakrificave personale të këtyre njerëzve që



Info **LIVE**  
Magazine

**MAVRAJ: SPECIALIA ÇAKTON SENACA NË DATA TË RËNDESISHME PËR K**

hirjen e tij në videon e publikuar ditë më parë nga ky subjekt politik me titull "Çka ka, çka



Info **LIVE**  
Magazine

## MAVRAJ: PO GJYKOHET KOKA E UÇK-së

ritanisë së Madhe për Ballkanin Perëndimor, Stuart Peach, gjatë vizitës në Beograd, është shprehur

janë atje (në Hagë), se këta mrë e dinin se do të jenë atje, iu nënshtruan presionit, në radhë të parë amerikan dhe gjithë perëndimit që ta formojnë këtë gjykatë. Pra është formuar që t'i ndihmojë Kosovës dhe jo ta dëmtojë Kosovën. Dhe duke mos e dëmtuar me asgjë këtë qëllim, ky shtet ka të drejtën të ndër marrë veprimet e veta, sepse është shtet sovran...

**"Info Magazine":** ... Z. Mavraj, përmendet veprimet që mund t'i ndërmerret shteti i Kosovës në këtë aspekt sepse është përmendur edhe prej kryeparlamentarit Glauk Konjufca që duhet një organ mbikëqyrës. Ngjashëm ka thënë edhe ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu. Deri më tash nuk është se kemi parë ndonjë nismë...

**Mavraj:** Mbikëqyrja është e barabartë me kontrollin (dhe nuk tingëllon mirë jashtë). Ne nuk mund t'i kontrollojmë gjykatat tona, por ne krijojmë kushte për funksionimin e drejtë të tyre. Për vëzhgim dhe mbledhje të fakteve në të gjitha anët, po, duke përfshirë faktet që ofrojnë avokatët, të akuzuarit, opinioni publik, profesionistët, pastaj nga aktet që ata i kanë nxjerrë, shkeljet e pafundme që ata gjyqtarë e prokurorë i kanë bërë. Mbase kjo shpie në formulimin e një pyetjeje për

Gjykatën Kushtetuese në të ardhmen, por jo në atë mënyrë, sepse do të ishte edhe kundër vullnetit të atyre që janë në Hagë, jo në atë mënyrë që Kosovës t'i ngelet barra që është përpjekur deri më sot ta heqë nga vetja. Faji pra. Kosova s'ka asgjë për të fshehur. Asnjëri nga ata që janë atje në Hagë këtu nuk është fshehur. Asnjëri nuk ka hezituar që të shkojë. Kanë dhënë dorëheqjet dhe kanë shkuar. Dhe kur kanë shkuar kanë kërkuar që mos të protestohet kundër gjykatës dhe të mos mbahen demonstrata në përkrahje të tyre, sepse është betejë juridike. Dakord. Por, si betejë juridike është e pabarabartë, siç e përmendi avokati parimin e barazisë së armëve, dhe e ka përmendur edhe në disa raste të mëpërparme dhe atë me shumë të drejtë. Është parim i shenjtë dhe ky parim po shkelet rregullisht që nga dita e parë, që të mos themi që nga dita kur është shpallur qëllimi për akuzën, 2020, që ishte ditë politike e atij Jack Smithit që tani është avancuar diku tjetër, në ShBA, sikurse edhe ai vendimeve me sy mbyllur, gjyqtari paraprak francez, i cili po kështu është avancuar në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Sot, siç e pamë udhëhiqte tjetërkush seancën parashqyrtuese...

### Ja kush përfitoi nga burgosjet e Hagës

**"Info Magazine":** Z. Mavraj, duhet të ju pyes për mënyrën se si e keni parë dhe si ka qenë edhe qasja e qeverisë në raport me ish-eporët e UÇK-së, me UÇK-në, marrë parasysh se së fundi pat edhe një deklaratë, një videomesazh të kryeministrit Kurti në raport me figurën kontraverse të politikanit serb, Oliver Ivanoviq. Dua të shoh se cili është këndvështrimi juaj, pikëpamja juaj sa i përket krejt qasjes që ka kjo qeveri në raport me luftën e fundit në Kosovë dhe për figurat, qoftë ato të UÇK-së, por edhe mënyrën e trajtimit të atyre që janë sikurse Oliver Ivanoviq, i cili kishte edhe një dënim të shkallës së parë për krime lufte...

**Mavraj:** Tash në qoftë se do t'i përgjigjem drejtpërdrejt pyetjes së drejtpërdrejtë do të thoja se kjo qeveri dhe ky grupacion politik në fuqi duke përfshirë presidenten, kryeparlamentarin, kryeministrin dhe të gjithë të tjerët rrotull tyre nuk do të vinin në pushtet pa i futur në burg këta njerëz. Dhe përfituesit direktë, përfituesit politikë të burgosjes janë këta njerëz. Përpara se t'i marrin këto pozita kanë bërë thirrje që këta të shkojnë në burg. Kanë bërë fushata shumë të forta kundër tyre. E kanë organizuar vrasjen morale të tyre duke filluar qysh pata dhjetë vitësh e më shumë, ashtu që kur të burgosen kjo të

përjetohej si një lloj çlirimi, sikurse ku ata marrin një komunë për ta udhëhequr të shihet si një komunë e çliruar ose zonë e çliruar.

**"Info Magazine":** Z. Mavraj ju po thonë se me mbajtjen në paraburgim të ish-krerëve të UÇK-së përfituan njerëzit e Lëvizjes Vetëvendosje?

**Mavraj:** Jo të Lëvizjes Vetëvendosje, por që të gjithë këta, përfshirë kryetaren e shtetit. Që të gjithë këta. Jo veç një Lëvizje. Ky ekip që e udhëheq shtetin e Kosovës është përfitues direkt. Prandaj, meqë ju më pyetët për veprimet e tyre, ato janë të natyrshme nëse i shohim në këtë plan, në këtë prizëm dhe se nuk pritet asnjë gjë, asnjë hajër nga ta, nga asnjë shkallë shtetërore ku prekin këta njerëz dhe as të mos shpresojë kush. Por, shteti nuk janë vetëm këta. Shteti janë edhe institucionet tjera, shteti janë edhe zgjedhjet e ardhshme, shteti janë edhe qytetarët tjerë, shteti jemi edhe ne këtu, avokatët, opinioni i lirë publik e kështu me radhë. Për fat të keq (pushtetarët) nuk janë në nivelin e detyrës ashtu që do t'i ndihmonin Kosovës edhe në planin diplomatik, edhe politik, edhe ligjor që të spastrohet Kosova nga këto akuza dhe që Kosova thjesht të jetë sa më e përafërt me frymën dhe vlerat e Perëndimit, e të cilat vlera më së shumti po i shkel vetë Perëndimi, për fat të keq, për absurd dhe për çudi të Zotit.

### Po errësohet imazhi i Kosovës

**"Info Magazine":** Dhe, krejt në fund z. Mavraj, shkurtimisht, se jemi në minutat e fundit, dua të ju pyes për një çështje shumë të rëndësishme nëse imazhi i UÇK-së mund të themi se po mbahet peng derisa ne të kemi një proces gjyqësor sepse ka nga ata që në Kosovë gjithçka tentojnë ta ndër lidhin me emra të përveçëm dhe jo me UÇK-në.

**Mavraj:** Imazhi i UÇK-së po se po, por edhe i Kosovës gradualisht po errësohet. Dhe në këtë lloj koncerti që po luhet, me deklarata, qoftë nga kryetarja e gjykatës speciale, qoftë nga ajo kryesuesja që e shpalli aktgjykimin ndaj Mustafës, qoftë këta prokurorët, rregullisht, qoftë nga këta qeveritarët tanë shumë naivë, qoftë nga ky tjetri dje a pardje me rastin e Oliver Ivanoviqit e kështu me radhë, gradualisht, gradualisht, gradualisht vetëm po e përmirësojnë imazhin e pushtesit të Kosovës dhe po e përkeqësojnë imazhin tonë, sepse të ngritësh, lartësosh njerëz kriminelë të përsosur si figurën e Oliver Ivanoviqit që ka vrrarë 50 shqiptarë dhe asnjë më pak, më shumë ndoshta po, por asnjë më pak sesa 50 shqiptarë, në vetvete flet ato që flet. Më të vërtetë UÇK-ja është shumë e dëmtuar, por shumë më shumë nga brenda këtu sesa jashtë.

**"Info Magazine":** Z. Mavraj, faleminderit shumë për kohën! Ishte kënaqësi të ju kemi në "Info Magazine".

**Mavraj:** Respekt!



## Mehaj në Pejë dhe Istog paraqet të arriturat e Ministrisë së Mbrojtjes

PEJË, 19 JANAR - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka paraqitur para qytetarëve të Pejës dhe të Istogut të arriturat e ministrisë që drejton. Në kuadër të këtyre takimeve në të dyja komunat, ministri Mehaj ka folur edhe për të arriturat e FSK-së, duke thënë se ushtria jonë çdo vit është duke ngritur kapacitetet e saj. Ai ka thënë se proceset rekrutuese në FSK janë më

transparente se kurdoherë. Sipas ministrit, e tillë do të jetë edhe përzgjedhja e 1 000 ushtarëve të rinj. "Ushtria është e popullit e në shërbim të të gjithëve, andaj ishte kënaqësi që para qytetarëve të Pejës e Istogut bashkë me kolonel Vocën të prezantojmë të arriturat e Ministrisë së Mbrojtjes, investimet në ushtrinë tonë si dhe synimet që kemi për t'u anëtarësuar në

organizata ndërkombëtare, me qëllim të mbështetjes së misioneve të shteteve partnere. Ushtri që ngritë çdo vit kapacitetet e saj është Forca e Sigurisë së Kosovës, dhe proceset rekrutuese janë më transparente se kurdoherë, e tillë do të jetë edhe përzgjedhja e 1 000 ushtarëve të rinj, konkurs i cili është i hapur deri me datën 23 janar", ka thënë Mehaj.



## Konjufca thotë se do ta shqyrtojnë kërkesën që lulëkuqja të bëhet simbol i gjenocidit në Kosovë

PRISHTINË, 19 JANAR - Një delegacion i Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur", i përbërë nga kryetari i Qendrës, Bardhyl Mahmuti, zëvendëskryetari Adnan Asllani dhe drejtuesi i Qendrës në Kosovë, Bujar Dugolli, u prit në takim nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca.

Temë e këtij takimi ishte kërkesa të cilën Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur" ua ka drejtuar institucioneve të Kosovës që lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol zyrtar i përkujtimit të viktimave të gjenocidit në Kosovë.

Delegacioni i Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur" e informoi në hollësi Konjufcën

lidhur me përmbajtjen e kërkesës që ua ka drejtuar institucioneve të Kosovës si dhe i dorëzoi dokumentacionin e nevojshëm me sqarime se çka përmban kjo kërkesë.

Kosova tashmë po hyn në çerekshkullin e gjenocidit ndaj shqiptarëve të cilin shteti serb e ka zbatuar gjatë luftës së fundit, andaj kërkohet një dinamizëm më i madh në hedhjen e hapave në rrugëtimin drejt ngadhënjimit të drejtësisë.

Nga ana e tij kryetari i Kuvendit, Konjufca, premtoi se do ta shqyrtojë me kujdes kërkesën e Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur" dhe do ta diskutojë me strukturat brenda Kuvendit të Kosovës për hapat e mëtutjeshëm.



## Kurti, pjesë e diskutimit për "Dialogun e diplomacisë për Ballkanin Perëndimor"



DAVOS, 19 JANAR - Në Forumin Ekonomik Botëror që po mbahet në Davos të Zvicrës, kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka diskutuar në sesionin me temë "Dialogu i diplomacisë për Ballkanin Perëndimor".

Kryeministri Kurti paraqiti të arriturat e Republikës së Kosovës në vitin 2022, përparimin ekonomik dhe demokratik. Ai ka theksuar nevojën për dinamizim të procesit të dialogut drejt normalizimit të plotë të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë me njohje reciproke në qendër.

Në këtë sesion kryeministri Kurti diskutoi krahas Edi Rama, kryeministër i Shqipërisë, Alexander Schallenberg,

ministër Federal për Çështjet Evropiane dhe Ndërkombëtare të Austrisë, Miroslav Lajčak, përfaqësues special i Bashkimit Evropian për Dialogun Kosovë - Serbi, Borjana Krišto, kryetare e emëruar e Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës, Andrej Plenković, kryeministër i Kroacisë, Mikulash Bek, ministër për Çështjet Evropiane të Republikës Çeke, e personalitete të tjera.

Ky sesion me pjesëmarrës udhëheqës të shteteve dhe organizatave ndërkombëtare u kryesua nga Borge Brende, president i Forumit Ekonomik Botëror, ndërsa u drejtua nga Mirek Dusek, drejtor menaxhues i Forumit Ekonomik Botëror.

## Ministrja Haxhiu në Qendrën Korrektuese në Lipjan, certifikohen pesë gra në punimet e filigranit

LIPJAN, 19 JANAR - Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka vizituar Qendrën Korrektuese në Lipjan, me rastin e ceremonisë së certifikimit të pesë grave në punimet e filigranit. "Qëllimi parësor i institucioneve korrektuese është rehabilitimi i qytetarëve që janë në

konflikt me ligjin, prandaj certifikimi i grave sot është dëshmi se ky qëllim për rehabilitim dhe aftësim është një hap më shumë drejt përmbyshjes së tij", ka thënë Haxhiu.

Ajo ka theksuar se këto trajnime do t'u ndihmojnë grave të aftësohen

profesionalisht si gjatë kohës brenda në institucion, ashtu edhe pas përfundimit të dënimeve më vonë. "Gratë dëshmojnë që janë punëtore në çfarëdo ambienti kudo që ato ndodhen. Faleminderit organizatës HELP për mbështetjen!", ka shkruar Haxhiu në "Facebook".



## “Walker i transmetoi botës atë që pa e përjetoi, të vërtetën që ajo duhet ta dinte”

PRISHTINË, 19 JANAR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur në takim ish-shefin e misionit të OSBE-së në vendin tonë, ambasadorin amerikan William Walker.

Konjufca ka theksuar se historia e udhëtimit të tij, veçanërisht dëshmia për masakrën e Raçakut, ishte kyçe në shtyrjen e NATO-s për ta nisur fushatën e saj të bombardimeve kundër Jugosllavisë. “Është një

kënaqësi e madhe për mua sa herë që takohem me ish-shefin e misionit të OSBE-së në vendin tonë, mikun e madh të Kosovës, ambasadorin amerikan William Walker. Z. Walker, pa iu trembur syri, i pati thënë Millosheviqit të vërtetën në sy dhe i transmetoi botës atë që pa e përjetoi, të vërtetën që ajo duhet ta dinte, në kohën kur Kosova po digjej flakë e populli i pafajshëm vritej e masakrohej brutalisht ditë e natë. Historia e

udhëtimit të tij, veçanërisht dëshmia për masakrën e Raçakut, ishte kyçe në shtyrjen e NATO-s për ta nisur fushatën e saj të bombardimeve kundër Jugosllavisë”, ka deklaruar Konjufca, duke shtuar se sot bashkë me Walkerin e kujtuan një pjesë të së kaluarës. “Diskutuam edhe për të arriturat në vend dhe zhvillimet aktuale në vend, rajon e botë. Mirënjohës gjithmonë për z. Walker”, ka theksuar Konjufca.



## PDK-ja, aksion në Kuvend: Unë i besoj Martin BëriShajt

**EPOKA E RE**

Mal QORRAJ

Prishtinë, 19 janar - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka vendosur në Kuvend, në vendin ku ulet kryeministri Albin Kurti, një pankartë ku shihet ai me ambasadorin Martin Berishaj.

Në pankartë shkruhet: “Unë i besoj Martin BëriShajt”. “Shkarkim dhe sjellje para drejtësisë për ambasadorin Martin Berishaj e jo mbrojtje për të. Hetim dhe përgjegjësi deri në zyrtarin e fundit të përfshirë në këtë skandal financiar e mafioz. Qoftë ai edhe kryeministri!”, ka shkruar në “Facebook” deputetja e PDK-së, Blerta Deliu.

Një ditë më parë vetë ambasadori i Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, ka dalë me një deklaratë për dyshimet që janë ndaj tij për përfshirje në një skandal të madh financiar. Ai ka thënë se nuk është pronar dhe as aksionar i asnjë ndërmarrjeje. “Nisur nga pretendimet dhe akuzat e pabaza që janë prezantuar nga disa media në Kosovë, jam i shtyrë që të dal publikisht me këtë deklaratë për qëllim të informimit të saktë të opinionit publik. Që në fillim dua t’ju informoj se nuk jam as pronar dhe as aksionar i asnjë ndërmarrjeje në Republikën e Kosovës, as në Republikën e Malit të Zi, as në rajon, dhe askund tjetër në botë”, ka shkruar Berishaj në “Facebook”.

Pretendimi se ai ka fshehur apo deklaruar rrejshëm pasurinë, thotë se nuk qëndrojnë dhe është i pavërtetë. Berishaj ka thënë se



akuzat ndaj tij janë të pabaza, tendencioze dhe i ka hedhur poshtë.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, në seancën e parë të sesionit pranveror të Kuvendit të Kosovës, ka kërkuar shkarkimin e ambasadorit Martin Berishaj dhe fillimin e hetimeve serioze lidhur me aferën e tij korruptive. “Tashmë është shumë vonë. Shkarkimi i ambasadorit Berishaj më nuk mjafton. Duhet të bëhen

hetime serioze dhe t’u jepet përgjigje pyetjeve - juridikisht, politikisht dhe moralisht. Martin Berishaj duhet të sillet para drejtësisë dhe kushdo qoftë që është në këtë piramidë”, ka thënë Krasniqi.

Ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, e pyetur nga gazetarët për rastin e ambasadorit të Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, ka thënë se deri në këto

momente nuk ka asnjë informacion zyrtar se Berishaj ka bërë ndonjë shkelje. “Unë kam kërkuar dhe vazhdoj të kërkoj nga shtetet të cilat janë përmendur që të na japin informacione se a janë të vërteta apo spekulime të medieve të ndryshme akuzat ndaj tij. Ambasadori nuk shkarkohet për shkak të spekulimeve mediale. Ai shkarkohet kur ka arsye faktike”, ka thënë ministrja Gërvalla.

Në lidhje për përfshirjen e ambasadorit të Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, në afëra milionëshe, Partia Socialdemokrate (PSD) para tri ditësh ka mbajtur një aksion simbolik te Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD). Aktivistët e PSD-së para MPJD-së kanë ndërruar flamujt duke vendosur kartëmonedhën me 500 euro me fytyrën e ambasadorit Martin Berishaj.

## Sërish reduktime të ujit për Fushë-Kosovën, Zonën Industriale, Kalabrinë dhe Obiliqin

PRISHTINË, 19 JANAR - Kompania Rajonale e Ujësjetësimit “Prishtina” ka njoftuar se si shkak i reshjeve të dendura atmosferike në afërsi dhe rreth liqenit të Ujmanit ka ngritje të turbullirës së ujit në kanal in e Ibrit Lepencit. Sipas këtij njoftimi, Impianti i Trajtimin të Ujit në Shkabaj dhe ai në Drenas nuk kanë mundësi teknike ta trajtojnë ujin për pije.

Si pasojë e kësaj, Fushë-Kosova së bashku me Zonën Industriale, lagjja Kalabria, Obiliqi do të kenë reduktime të ujit duke filluar sot nga ora 10:00 dhe do të zgjasë deri në 16:00, pastaj ujtë do të ketë nga ora 16:00-20:00, pastaj reduktim nga ora 20:00-04:00 të mëngjesit. “Në pozitë më të rënduar e kemi komunën e Drenasit, por autobotët/autocisternat do të

jenë aty për t’i furnizuar qytetarët me ujë. Po ashtu, edhe në Fushë-Kosovë në kohën e reduktimit do të vendosim autobotë për furnizim me ujë deri në tejkalimin e situatës. Fshatrat e Podujevës do të reduktohen gjatë ditës diku rreth 3 orë. Një situatë e tillë vazhdon deri në përmirësimin e situatës me turbullirë në kanal”, theksohet në njoftimin për medie.



## Vlera e koeficientit të pagave mbetet sekrete

PRISHTINË, 19 JANAR - Për më pak se tri javë pritet të hyjë në fuqi Ligji i ri i Pagave në Kosovë, por asnjëri prej punëtorëve në sektorin publik nuk e di se sa do ta ketë pagën. Ligji, i miratuar në dhjetor të vitit të kaluar, nuk e ka përfshirë vlerën e koeficientit e cila përcakton një tavan deri ku mund të paguhet një punonjës i shtetit.

Si i tillë, Ligji është dekretuar tashmë nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare.

Zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se vlera monetare e koeficientit do të caktohet gjatë këtij muaji, por nuk jep detaje se sa mund të jetë ajo. Sipas Ligjit për Buxhetin e vitit 2023, i miratuar po ashtu në dhjetor të vitit të kaluar, buxheti i përgjithshëm për paga në sektorin publik do të jetë 745 milionë euro.

Aktualisht, paga mesatare bruto në Kosovë është rreth 480 euro në muaj.

"Radio Evropa e Lirë" ka marrë vesh nga burime brenda institucioneve të Kosovës se vlerat e diskutuara monetare të koeficientit janë 100 euro, 120 euro dhe 130 euro. Shuma e caktuar do të shumëzohet pastaj me nivelin e koeficientit - që varion nga 2 deri në 18 - dhe do ta prodhonte vlerën e pagës.

Përfaqësues të punëtorëve kritikojnë qeverinë për mospublikimin e vlerës së koeficientit dhe mospërfshirjen e saj në ligj.



"Jemi në pritje. Urojmë që [koeficienti] të mos jetë më i ulët se 120 euro", thotë për "Radion Evropa e Lirë" Rrahman Jasharaj, kryetar i Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK).

Me këtë vlerë të koeficientit, thotë ai, pagat në sektorin e arsimit do të rriteshin.

Për shembull, mësimdhënësit në arsimin e mesëm të ulët nivelin e koeficientit e kanë 5.6. Paga e tyre është 530 euro, me vlerën monetare të koeficientit 120 euro, ajo do të rritej në 672 euro.

**Gashi: 120 euro na ka thënë kryeministri**

Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve në Administratë Publike, Ali Gashi, thotë se kjo

organizatë ka kërkuar që vlera monetare e koeficientit të jetë 130 euro, por se për të nuk ka marrë garanci. "Në një takim me kryeministrin [Albin Kurti] e kam pyetur se sa do të jetë vlera e koeficientit dhe më ka thënë përafërsisht 120 euro. Nëse nxirret një vlerë e koeficientit jo e dinjitetshme, atëherë jemi mashtruar nga qeveria", thotë Gashi për "Radion Evropa e Lirë".

Ligji paraprak për Pagat e Shërbyesve Civilë, i cili më pas është shfuqizuar, e ka pasur vlerën monetare të koeficientit 239 euro për vitin e parë të zbatimit të këtij ligji.

Ky ligj është miratuar në shkurt të vitit 2019, por një muaj para se të niste zbatimin i tij - në janar të vitit 2020 - institucioni i Avokatit të Popullit e ka dërguar atë në Gjykatën Kushtetuese

për, siç ka thënë, "vlerësimin e përputhshmërisë" së tij me Kushtetutën e Kosovës.

Edhe për Ligjin aktual për Pagat, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), më 6 janar, ka deponuar tek Avokati i Popullit kërkesë për fillimin e hetimeve për, siç ka thënë, shkelje të drejtave të njeriut.

IKD-ja, në këtë kërkesë, ka vlerësuar se Ligji cenon sigurinë juridike të nëpunësve të sektorit publik, duke mos e përcaktuar vlerën monetare të koeficientit.

IKD-ja, po ashtu, ka thënë se ka gjetur se Ligji në fjalë përmban disa dispozita të cilat paraqesin trajtim të pabarabartë të nëpunësve të sektorit publik - aspekt ky që, sipas IKD-së, paraqet shkelje të nenit 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Institucioni i Avokatit të Popullit konfirmoi për REL-in se e ka pranuar këtë kërkesë dhe tha se do ta shqyrtojë "brenda afatit ligjor", që është 30 ditë.

**Raporti i koeficienteve 2:18**

Me Ligjin e ri për Pagat niveli i koeficienteve sillet nga 2 deri në 18 - më i larti i takon vetëm presidentes së shtetit. Më i ulëti, ndërkaq, u takon pozitave si: rekrut/kadet i Forcës së Sigurisë së Kosovës, kadet policor, kadet doganor dhe kadet korrektues.

Paga e një punëtori do të llogaritet duke e shumëzuar nivelin e koeficientit të pagës së një pozite me vlerën monetare të koeficientit.

Ligji për paga zbatohet për punonjësit e sektorit publik, pagat e të cilëve financohen nga buxheti i shtetit, me përjashtim të punëtorëve të Agjencisë Kosovare për Inteligjencë (AKI). Numri i punonjësve që marrin paga nga buxheti i Kosovës është rreth 83 mijë.

Kuvendi i Kosovës ka miratuar në lexim të parë edhe projektligjin që do t'i hapte rrugë rritjes së pagës minimale, por nga qershori i vitit të kaluar - kur ka ndodhur kjo - nuk ka pasur ndonjë zhvillim tjetër.

Paga minimale në Kosovë aktualisht është 130 deri në 170 euro. Kjo vlerë, e pandryshuar qysh në vitin 2011, është më e ulëta në Evropë, sipas Agjencisë Evropiane të Statistikave "Eurostat".

## ZKA-ja nis vitin me zbatimin e planit për zhvillimin profesional të punonjësve

PRISHTINË, 19 JANAR - Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale të stafit vazhdon të jetë prioritet i Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) edhe për këtë vit. Prandaj nëpërmjet planin vjetor të trajnimeve dhe zhvillimit profesional janë adresuar nevojat dhe kërkesat e punonjësve për zhvillim në fusha specifike.

Zbatimi i planit të trajnimeve për muajin janar ka filluar me mbajtjen e trajnimit për stafin auditues "E-Prokurimi" nga ligjërues të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) i cili po realizohet në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit në mes të dy institucioneve.

Auditimi i sistemit të prokurimit publik është jashtëzakonisht i rëndësishëm, prandaj avancimi profesional i auditorëve në këtë fushë është i domosdoshëm dhe ndikon në rritjen e

përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike në Kosovë.

Po gjatë kësaj jave stafi auditues do ta ndjekë edhe trajnimin "E-Pasuria" i cili do të mbahet nga zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (MPBAP). Nga ky trajnim auditorët do t'i avancojnë njohuritë e tyre sa i përket sistemit E-Pasuria në përgjithësi, përkatësisht modulit të raportimeve pasi ajo është pjesë me interes më të lartë për ta.

Auditorët do të kenë qasje monitoruese në sistemin E-pasuria gjatë punës në terren gjë që do ta bëjë auditimin më efektiv dhe efikas.


Edhe në javën e tretë të janarit për punonjësit e ZKA-së do të mbahen edhe dy trajnime të tjera lidhur me "Shkrimin e raporteve dhe përdorimin e gjuhës së thjeshtë" si dhe



trajnimi për "Rritjen e aftësive për ligjërime dhe mësim". Gjithashtu, në fund të këtij

muaji do të mbahet edhe trajnimi i brendshëm për stafin e ri dhe auditorët juniorë për

auditim financiar "Qasja e Auditimit të Pasurisë (menaxhimi i pasurisë).



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

## Edhe FIFA konfirmon përkrahjen për futbollin e Kosovës

Futboli i Kosovës ka marrë mbështetje nga FIFA. Kryetari i FFK-së, Agim Ademi dhe ministri i MKRS-së, Hajrulla Çeku, janë takuar me numrin një të FIFA-s, Gianni Infantino. "Edhe në këtë takim diskutimet ishin tejet përmbajtjesore dhe janë shpresëdhënëse se në të ardhmen futbollin e Kosovës do të jetë në një nivel tjetër në aspektin e infrastrukturës", ka thënë Ademi



**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 19 JANAR** - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, janë pritur në takim nga presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino.

Numri një i FFK-së me anë të një postimi në "Facebook" ka thënë se futbollin e Kosovës edhe një herë tjetër ka marrë përkrahje nga FIFA. "Jam i nderuar për pritjen tejet të përzemërt të presidentit të FIFA-s, Gianni Infantino, në Shtëpinë e Futbollit në Cyrih, ku së bashku me ministrin Hajrulla Çeku prezantua planin investiv pesëvjeçar të MKRS-së për përmirësimin e infrastrukturës së stadimeve të futbollit, projekt në të cilin do të jenë të përfshira edhe FFK dhe komunat. Edhe në këtë takim diskutimet ishin tejet përmbajtjesore dhe janë shpresëdhënëse se në të ardhmen futbollin e Kosovës do të jetë në një nivel tjetër në aspektin e infrastrukturës", ka thënë Ademi.

Sipas Ademit, presidenti Infantino u shpreh i lumtur që Qeveria e Kosovës dhe komunat janë afër FFK-së për realizimin e projekteve që kanë synim përmirësimin e infrastrukturës së futbollit. "Infantino lavdëroi institucionet tona që e kanë vendosur si prioritet përmirësimin e infrastrukturës së futbollit pasi, siç tha, rinia dhe talentet e shumta në Kosovë meritojnë që t'u krijohet kushte më të mira", ka shtuar Ademi. Gjithnjë sipas kryetarit të FFK-së, Infantino i ka uruar Kosovës një nismë sa më të mbarë të ciklit të ardhshëm kualifikues dhe shprehu besimin e tij për sukses të "dardanëve". "Presidenti Infantino edhe një herë më përgëzoi për punën e deritashme dhe theksoi se dera e FIFA-s për ne do të jetë gjithmonë e hapur pasi, siç tha, Kosova zë vend të veçantë në zemrën e tij. Nga ana ime i shpreha mirënjohjen më të thellë për mbështetjen që i jep futbollit të Kosovës dhe për gatishmërinë e tij për të qenë afër FFK-së në çdo projekt", ka përfunduar Ademi.

Të mërkurën kryetari i FFK-së, Agim

Ademi dhe ministri i MKRS-së, Hajrulla Çeku, janë pritur në selinë e UEFA-s në Nion nga Aleksandër Çeferin. Temë diskutimi e këtij takimi ishte çështja e infrastrukturës së futbollit në të gjithë Kosovën. Me këtë rast, ministri Çeku e shpalosi planin pesëvjeçar të ministrisë që drejton për ndërtimin e stadimeve të reja dhe renovimin e stadimeve ekzistuese. Sipas këtij projekti, Kosova në të ardhmen do t'i ketë katër stadime të kategorisë së katërt të UEFA-s, shtatë stadime të kategorisë së dytë dhe 12 stadime lokale. Presidenti i UEFA-s e vlerësoi projektin e paraqitur si shumë të mirë dhe theksoi se do të gjejnë rrugë për pjesëmarrje dhe mbështetje financiare të këtij projekti në kuadër të programit "hat-trick", por edhe nga fonde të tjera të UEFA-s.

Kryetari Ademi dhe ministri Çeku e falënderuan kreun e UEFA-s për pritjen e ngrohtë dhe për gatishmërinë e tij për ta përkrahur idenë e këtij projekti në të gjitha format, por edhe për mbështetjen e vazhdueshme që ai po i jep futbollit të Kosovës.

### SHKURT

#### Kosova U17 pëson humbje nga Bullgaria

Përfaqësuesja e Kosovës U17, femrat, është mposhtur nga Bullgaria me rezultat 0-3 (19:25; 20:25; 14:25), në kuadër të ndeshjes së dytë kualifikuese të Kampionatit Evropian të kësaj grupmoshe që po mbahet në Ankara të Turqisë. Ndeshjen e tretë dhe të fundit në këto kualifikuese, Kosova e zhvillon sot (e premte) kundër Moldavisë me fillim nga ora 18:00.

#### Engin Gencoglu emërohet trajner i KB Trepça

KB Trepça e ka prezantuar trajnerin e ri Engin Gencoglu. Kjo lëvizje e klubit nga Mitrovica është befasuese për faktin se në fillim të kësaj jave Ilir Selmani e mori drejtimin e këtij klubi pas largimit të Alek Jonçevskit. "Engin Gencoglu i bashkohet shtabit teknik të klubit. Engin Gencoglu së bashku me Ilir Slemanin pritet të sjellin vlerë të shtuar në ekip dhe ta udhëheqin ekipin drejt objektivave", thuhet në njoftimin e KB Trepçës.

#### Ekipi i skitarëve të Kosovës përgatitet në Itali

Ekipi i skitarëve po përgatitet në Kronplatz të Italisë para garave të Festivalit Olimpik Evropian Dimëror për të Rinj (EYOF) "Friuli, Venezia, Giulia 2023", që prej 21-28 janarit 2023 mbahet në Itali. Shpenzimet e përgatitjeve po mbulohen nga KOK-u. Në përgatitje po marrin pjesë garuesit Lirika Deva, Engji Sefaj dhe Klos Vokshi, së bashku me trajnerët Kushtrim Deva dhe Ernest Sefaj.

#### Haliti përforcon Trepçën '89

Mbrojtësi i njohur Ahmet Haliti e ka përforcuar skuadrën e Trepçës '89, e cila bën gara në Superligën e Kosovës në futboll. "Trepça '89 njofton për arritjen e marrëveshjes me futbollistin e mirënjohur kosovar Ahmeti Haliti. Haliti njihet për eksperiencën e tij në futbollin kosovar. Ka qenë pjesë e ekipeve si KF Hysi, FC Prishtina, KF Feronikeli dhe KF Llapi. Gjithashtu, trofetë nuk i mungojnë në karrierë ku gjithsej ka një titull të kampionit, tri Kupa dhe një Superkupë. Haliti gjithashtu ka luajtur edhe në kampionatin shqiptar. Haliti i urojmë shumë suksese në fanellën gjelbërëbardhë", thuhet në njoftimin e KF Trepça '89.

## Mgbeike, me dyshifror të trefishtë, shpallet MVP e javës

**PRISHTINË, 19 JANAR** - Në mesjavë u zhvillua xhiroja e gjashtë e Ligës Unike te femrat. Prishtina fitoi në derbin në mes kryeqyteteve, duke mundur Tiranën, ku si zakonisht basketbollistja më e dalluar ishte Sarah Mgbeike me dyshifror të trefishtë. Ajo realizoi 21 pikë, 15 kërcime dhe dhjetë asistime, duke

qenë një nga lojtaret më të mira të kësaj lige. Mgbeike kishte indeksin 40, apo dukshëm më të lartë në këtë xhiro. Agnesa Rrahmani zhvilloi një tjetër ndeshje të mirë, duke hyrë në topesëshe, me 29 pikë. Bashkimi ia shkaktoi humbjen e parë Flamurtarit në këtë edicion. Te skuadra

prizrenase u dalluan Arbnore Përquku me 16 pikë e 14 asistime, ndërsa shtoi edhe gjashtë kërcime. Ajo u ndihmua nga Dasiva Evans me 17 pikë, pesë kërcime e dy asistime. Partizani shënoi fitore shumë të rëndësishme, ku më e dalluara ishte Ornela Lalaj me dyshifror të dyfishtë, 19 pikë e 12 kërcime.



## Nga Australian Open eliminohet edhe numri dy në botë

**MELBOURNE, 19 JANAR** - Viojnë surprizat në grand slam-in e Australian Openit, teksa luhen takimet e raundit të dytë. Numri dy në botë për meshkuj, norvegjezi Casper Ruud, u mund 3-1 nga amerikanin Jenson Brooksby (6-3, 7-6, 6-7, 6-2).

Kështu, nga ky turne mungojnë 3 më të mirët në botë, pas eliminimit të Nadalit dhe mungesës së Alcaraz (i dëmtuar). Në ndeshjet e tjera për meshkuj, spikat fitorja e numrit gjashtë në botë, rusit Andrey Rublev, që fitoi 3-1 ndaj finlandezit E.

Ruusuvuori. Britaniku Daniel Evans fitoi 3-0 ndaj francezit Jeremy Chardy, ndërsa francezi Ugo Herbert eliminoi amerikanin D. Kudla, duke fituar 3-1. Te femrat avancon në raundin e tretë bjellorusja Aryna

Sabalenka, që mundi 2-0 (6-3, 6-1) amerikanen Shelly Rogers. Eliminohet edhe rusja Veronika Kudermetova, numri 9 në botë, që u mund 2-1 nga amerikania K. Volynets. Avancën edhe polakja Magda Linette, që mundi 2-1 estonezen Kontaveit,



ndërsa çekja Karolina Pliskova fitoi 2-0 ndaj kazakes Putinseva.

## Benzemës i përfundon kontrata në qershor, Reali ende asnjë lëvizje

**MADRID, 19 JANAR** - Fituesi i "Topit të Artë", Karim Benzema, nuk e di se ku do të luajë sezonin e ardhshëm, pasi i skadon kontrata me Real Madridin në muajin qershor dhe ende nuk ka diçka konkrete lidhur me rinovimin e saj. Besohet se në Real Madrid janë të gatshëm për të rinovuar me sulmuesin francez, por 35-vjeçari nuk dha asnjë informacion dhe ka lënë në pikëpyetje të ardhmen e tij. "Jam i fokusuar te puna këtu në Madrid dhe po shijoj çdo stërvitje dhe çdo ndeshje. Nuk mund të them asgjë për të ardhmen time. Ajo që mund t'ju them për momentin është se do ta shijoj në maksimum kohën time në Madrid. Thjesht po fokusohem te puna që ta marrim maksimumin nga pjesa e dytë e sezonit, ndërsa të ardhmes nuk i dihet kurrë, e



sidomos në futboll", ka thënë Benzema. Sipas medieve spanjolle, Real Madridi do të presë deri në fundin e sezonit dhe më pas do të diskutojë së bashku me sulmuesin për të ardhmen, për faktin se madrilënët kërkojnë kohë për të kuptuar nëse Benzema do të jetë i gatshëm për të vazhduar, duke

përfshirë këtu edhe problemet e tij fizike që e shqetësuan në fillimin e këtij edicioni. Për momentin Benzema mbetet një temë shumë e rëndësishme në Madrid, ndërsa admiruesit e tij janë aty për të përfutur në çdo moment pasi, pavarësisht moshës, Benzema mbetet një prej sulmuesve më të mirë.

## Lakersat zhgënjejnë sërish, Memphisi nuk i ndahet Denverit në Perëndim

**LOS ANXHELOS, 19 JANAR** - Denveri qëndron në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit pas fitores me rezultat 122-118 ndaj Minnesotas, ndeshje me rivalitet deri në fund. Nikola Jokiq realizoi sërish një "triple-double", me 31 pikë, 11 rebounde e 13 asistime, duke qenë lider në fushë për Denverin, mbështetur edhe nga Murray me 28 pikë. Të njëjtin ritëm mban Memphisi, që mundi me rezultat 115-114



Clevelandin dhe qëndron pas Denverit në renditje. Bane me 25 pikë e Morant me 25 bënë diferencën në parket për Memphisin. Zhgënjejnë sërish lakersat, që në fushën e tyre u mundën me rezultat 116-111 nga Sacramento (Fox 31 pikë). James realizoi 32 pikë, por që mbetën për statistikë. Miami ngjit shkallët e renditjes në Lindje pas

fitores me rezultat 124-98 ndaj New Orleansit, ndeshje ku Adebayo realizoi 26 pikë. Atlanta (8 lojtare mbi 10 pikë), falë 30 pikëve të D. Murrayt, mposhti me rezultat 130-122 Dallasin (Donqiq 30 pikë). Fitoi edhe ekipi i Utah Jazzit, që mundi me shifrat 126-103 clippersat, me Markkanen protagonist, autor i 34 pikëve e 12 reboundeve.

### REZULTATET

Dallas - Atlanta	122-130
New York - Washington	105-116
Houston - Charlotte	117-122
Memphis - Cleveland	115-114
New Orleans - Miami	98-124
Oklahoma - Indiana	126-106
Utah Jazz - Clippers	126-103
Denver - Minnesota	122-118
Lakers - Sacramento	111-116

## PSG-ja ishte e gatshme ta shesë Mbappen te Liverpooli

Ylli i Paris Saint-Germain, Kylian Mbappe, pati mundësinë të largohej nga klubi verën e kaluar. Sulmuesi francez ishte

shumë i lidhur me një transferim të lirë në Real Madrid. Megjithatë, parisienët ishin të gatshëm ta shisnin Mbappe vetëm te

gjigantët e Ligës Premierë, Liverpool. Përfundimisht Mbappe nënshkroi një kontratë të re me PSG-në për dy vjet të tjera dhe fitime

marramendëse. Sipas "The Athletic", Liverpooli është skuadra e vetme për të cilën ai mund të ishte larguar derisa ishte ende nën

kontratë me PSG-në. Mbappe ka deklaruar prej kohësh dëshirën e tij për të luajtur për Real Madridin një ditë.

### SHKURT

#### Bayerni arrin marrëveshje me Sommerin

Reprezentuesi i Zvicrës, Yann Sommer, do të jetë futbollist i Bayern Munchenit. Eksperti i transferimeve, Fabrizio Romano, shkruan se kontrata është kompletuar dhe njoftimi zyrtar do të vijë së shpejti. Portieri zvicran Sommer vjen te Bayerni, pasi Manuel Neuer pësoi një lëndim të rëndë gjatë skijimit. Ndërkohë, Jonas Omlin do ta zëvendësojë Sommerin te Borussia Monchengladbachu.

#### Dzeko: Fitorja ndaj Milanit është e merituar

Sulmuesi Edin Dzeko është shpallur lojtar i ndeshjes së Superkupës, ku Interi triumfoi ndaj Milanit me rezultat 3-0. Sulmuesi boshnjak është shprehur i lumtur me fitoren e arritur, duke thënë se Interi e meritoi triumfin ndaj rivalëve. "Jam i emocionuar, i lodhur, por shumë i lumtur, sepse fituam një tjetër kupë. E luajtëm jashtë shtëpisë dhe kundër rivalëve tanë, kjo na jep edhe më shumë kënaqësi", ka thënë Dzeko. "Sigurisht që mund të na japë edhe më shumë besim dhe energji. Ne fituam vitin e kaluar, erdhëm këtu për t'u përgatitur shumë mirë për ndeshjen. E dinim që Milani është një ekip i rrezikshëm, por djemtë tanë ishin të mrekullueshëm, fitorja është shumë e merituar", është shprehur Dzeko.

#### Gundogani në verë shkon te Barça

Mesfushori i Manchester Cityt, Ilkay Gundogan, pritet të jetë lojtar i Barcelonës nga vera e këtij viti, njofton "El Chiringuito". Kontrata e mesfushorit me klubin anglez përfundon në fund të këtij sezoni, kurse ai ka arritur marrëveshje me klubin nga "Camp Nou". Barcelona ka kohë që qëndron pas Gundoganit dhe është një emër që u përshatet prioritetëve të saj sportive dhe ekonomike.

#### Pioli: Humbja ndaj Interit dhemb shumë

Stefano Pioli e ka pranuar se Milani nuk bëri mjaftueshëm në humbjen e Superkupës së Italisë ndaj Interit dhe po bën shumë gabime. "Pjesa jonë e parë sigurisht që nuk ishte në lartësinë e detyrës, bëmë shumë gabime dhe prej andej ishte e vështirë të ktheheshim. Ne u përpoqëm në fillimin e pjesës së dytë, por nuk bëmë sa duhet për të merituar më shumë", ka thënë Pioli për "Sport Mediaset". "Është e qartë se ne nuk jemi mësuar me këto gabime dhe ato bëhen shumë të dëmshme ndaj një skuadre të kësaj cilësie. Sigurisht që nuk po kalojmë periudhën tonë më të mirë mendërisht, por duhet të bëjmë më mirë dhe të bëjmë më shumë", ka shtuar trajneri i klubit kuqezi. Ai vazhdoi duke thënë se humbja ndaj Interit dhemb shumë. "E vetmja mënyrë për të ecur përpara është të punojmë më mirë, të rrisim nivelin tonë, sepse është e qartë se kjo është një humbje që dhemb, një trofe që donim ta fitonim, por sezoni është ende i gjatë duke na pritur dhe ne duhet të rikthehemi. duke luajtur ashtu siç dimë ne", ka deklaruar Pioli.



NDËRMARRJA  
PUBLIKE  
BANESORE

Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë  
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672  
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, Neni 4, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A në Prishtinë, shpall:

### KONKURS *Për plotësimin e vendit të punës*

**Titulli i punës:** Menaxher/e i/e Departamentit për planifikim, Projektim dhe Mbikëqyrje

**Numri i Referencës:** NPB/ DPPM/ 07

**I raporton:** Kryeshefit Ekzekutiv dhe Udhëheqësit të Operativës

**Niveli i pagës:** 3

**Orët e Punës:** 40 orë në javë

**Kohëzgjatja e Kontratës:** Me kohë të pacaktuar ( periudha provuese 3 muaj)

**Vendi Punës:** Rr. "Zija Shemsiu" nr. 22, Ulpianë- Prishtinë ( selia e Ndërmarrjes Publike Banesore)

#### Detyrat e përgjithshme:

- Është përgjegjës/e për realizimin e objektivave të caktuara nga Udhëheqësi i Operativës dhe Kryeshefit Ekzekutiv që kanë të bëjnë me Departamentin për planifikim, projektim dhe Mbikëqyrje – DPPM;
- Përfaqëson NPB-në te palët e tjera me autorizim të Kryeshefit të NPB-së;
- Ndihmon në përgatitjet e procedurave dhe akteve tjera nënligjore për NPB-në;
- Ndihmon Kryeshefit në kaktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përbushjen e këtyre objektivave për DPPM-në;
- Merr pjesë në mbledhjet e rregullta me Kryeshefit Ekzekutiv dhe menaxhmentin e NPB-së;
- Koordinon punët me Kryeshefit Ekzekutiv dhe të gjitha Departamentet e NPB-së në lidhje me kërkesat dhe nevojat për kryerjen e aktiviteteve të nevojshme që kanë të bëjnë me DPPM-në.

#### Detyrat dhe përgjegjësitë specifike:

- Është përgjegjës për identifikimin, përpilimin, organizimin dhe realizimin e të gjitha planeve të DPPM-së;
- Analizon praktikatat dhe proceduarat e punës me qëllim të rritjes së efikasitetit si dhe propozon modifikimin apo përshtatjen e tyre sipas nevojës dhe zhvillimit të DPPM-së;
- Përgatit planet afat-mesme dhe afatgjata të DPPM-së;
- Përgatit planin e të hyrave dhe shpenzimeve vjetore për DPPM-së;
- Është përgjegjës për përpilimin dhe realizimin e planit të buxhetit, planit të prokurimit, plani të punës si dhe planeve të tjera në DPPM-së në dinamikë mujore dhe kumulative;
- Përgatit raportet financiare për DPPM-së;
- Përgatit raportet e punës në baza javore, mujore, vjetore për DPPM-në;
- Propozon për emërim në pozita adekuate punonjësit e divizionit në bazë të performancës në kordinim me Divizionin e Burimeve Njerzore dhe me aprovimin e Kryeshefit dhe Udhëheqësit Operativ;
- Është përgjegjës për performimin e stafit, bën vlerësimin e secilit të punësuar në departamentin që menaxhon në baza mujore, gjashtë mujore dhe vjetore;
- Siguron që niveli i punonjëseve, pajisjet dhe sistemet janë adekuate për përbushjen e funksioneve të DPPM-së;
- Siguron që stafi të ketë kualifikimin dhe trajnimet e duhura, mban një pasqyrë për nevojat për trajnime dhe organizon trajnimet e nevojshme;
- Bashkëpunon ngushtë dhe Mbikëqyr me Udhëheqësin e Divizionit për planifikim dhe projektim dhe Divizionit për Mbikëqyrje në përbushjen e objektivave të bazuara në planin e punës;
- Merr masa disiplinore ndaj punonjëseve që kanë performancë të dobët në përbushjen e detyrave të punës në koordinim me Divizionin e Burimeve Njerzore dhe Udhëheqësin Operativ;
- Kontrollon punët dhe mban mbledhje me stafin përgjegjës për punët e kryera ose për pengesat në punë.

#### Detyrat dhe obligimet tjera shtesë:

- Udhëheqësi i operativës dhe Kryeshefit ekzekutiv mundet ta ngarkojë me detyra tjera sipas nevojës së NPB-së;
- Në rast të mungesës së udhëheqëseve tjerë me urdhër të menaxhmentit mund ta zëvendësojë dhe ti kryen detyrat tyre në afat të caktuar.

#### Kualifikimet:

- Diplomë universitare në Arkitekturë; (ose relevante)
- Dëshmi për përvojë punë me së paku 4 vite;
- Dëshmi për përvojë punë me së paku 2 vite në menaxhim, udhëheqje në lëminë e Arkitekturës.

#### Aftësitë:

- Aftësi kompjuterike posaçërisht mbi sistemet kompjuterike në fushën e teknikës CAD;
- Aftësi kompjuterike në gjithë aplikacionet e MC Office;
- Njohje e sektorit publik lokal/qendror;
- Njohje e gjuhës Angleze;
- Njohuritë e qasjeve moderne në planifikim dhe kontrollë;
- Shkathtësi të shkëlqyera komunikative, organizative dhe analitike;
- Etikë në punë dhe integritet të lartë;
- Shkathtësi për të punuar në grup, nën presion dhe të dëshmoj fleksibilitet në punë;

#### Kualifikimet e preferueshme:

- Preferohet diploma - master në Arkitekturë (ose ekuivalente);
- Kurset dhe trajnimet tjera gjate karrierës profesionale.
- Patent shofer kategorija-B;

#### Dokumentet që duhet të bashkangjiten:

- Aplikacioni i NPB-së;
- Dëshmitë për Shkollim- Diplomë Universitare/ Arkitekturë ( ose relevante);
- Dëshmitë për përvojën e punës së paku 4 vite;
- Dëshmi për së paku 2 vite përvojë pune menaxhim, udhëheqje në lëmin e arkitekturës.
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime nga Gjykata (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Kopjen e letërnjoftimit;

**Shënim:** Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit të aplikimit, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda dy (2) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen. **Kandidati/ja i/e përgjegjës/ur obligohet të sjellë certifikatën mjekësore para nënshkrimit të kontratës.**

**APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËRKESAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË SHPALLJE SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.**

**Shpallja është e hapur që nga data 13.01.2023 deri më 27.01.2023.**



NDËRMARRJA  
PUBLIKE  
BANESORE

Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë  
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672  
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

